



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:148974

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05853020

KF.nr.466/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit, “Prishtina 1” ShPK me numër unik identifikues 810837619 dhe seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” Sh.P.K me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, kundërvajtje doganore, vlera e kontestit 250 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor – publik, të mbajtur me datë 13.06.2024, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Gentiana Behluli dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur Krenare Shala, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Prishtina 1” ShPK me numër unik identifikues 810837619 dhe seli në Prishtinë, si e pa bazuar.
- II. Mbetet në fuqi Aktvendimi nr. 03.2.2/7013 i datës 26.05.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 08.07.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, të aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore dhe për shkak të vendimit mbi gjobën kundërvajtëse, Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e ushtruar ndaj vendimit të Doganës, të anulohet aktvendimi i Doganës së Kosovës në Prishtinë nr. 03.2.2/7013 datë 26.05.2021, sipas të cilit vendim është refuzuar si e pabazuar kërkesa e

paditësit për rishqyrtimin e vendimit të sektorit për kundërvajtje doganore 03.1.7-20-488 i datës 20.04.2021, sipas të cilit vendim subjekti në procedurë është shpallur përgjegjës për kundërvajtje doganore sipas nenit 276 pika (h) të KDA-së. Përfaqësuesi i palës paditëse si në padi, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se mbeten në tërësi pranë kërkesëpadisë. Shton se e paditura në mënyrë jo të drejtë e ka dënuar paditësin me gjobë për kundërvajtje administrative me pretendimin se i njëjti gjatë zhdoganimit të mallit R 7502/2021 dt. 19.04.2021 nuk ka ofruar dokumente dhe shënimet e nevojshme për zbatimin e dispozitave doganore. E paditura përveç se e ka cituar këtë nen nuk e ka arsyetuar se çfarë procedurash doganore nuk kanë qenë të mundura të zbatohen me veprimin e paditësit. Paditësi nuk ka tentuar shmangien nga detyrimet doganore dhe kjo është e qartë pasi metoda e vlerësimit të mallit sipas DUD të lartpërmendur është metoda e parë e vlerësimit që do të thotë se e paditura vlerësimin e mallit e ka bërë sipas faturës së mallit të deklaruar nga paditësi. Gjykatës i ka kërkuar të anuloj vendimi e të paditurës dhe të obligoj të paditurën që t'ia kthej paditësit shumën prej 250,00 euro e paguar në emër të gjobës.

E paditura, në përgjigje në padi të datës 27.10.2021 e konteston në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi është marr në bazë të dispozitave ligjore që janë në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se qëndrojnë prapa përgjigjes në padi sepse vendimi i atakuar në padi është i drejtë dhe i ligjshëm dhe është marrë konform dispozitave ligjore të KDA, po ashtu e kundërshtojnë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi pasi që komisioni i formuar për kundërvajtje doganore ka vërtetuar aktvendimin e sektorit të kundërvajtjes duke shpallur përgjegjës paditësin për arsye se gjatë kontrollës nuk ka paraqitur saktë të dhëna me anë të deklaratës doganore R 7502/2021 me emërtimin gjel për pastrimin e menjëhershëm të duarve me kodin tarifor 2905120000, ndërsa nga sektori i tarifës është konstatuar se kemi të bëjmë me dezinfektues me kodin tarifor 3808949000 e që me veprimin e tillë doganës nuk i ka ofruar sqarimet e nevojshëm për zbatimin e procedurës doganore duke rënë ndesh me dispozitat e nenit 276 par. h). Më tej ka shtuar se është fakt se bazuar në kodin tarifor të deklaruar nga paditësi nuk kërkohet që të paguhen taksat doganore prej 10%, ashtu siç nuk kërkohet edhe me kodin tarifor të klasifikuar nga sektori i tarifës, mirëpo në kodin tarifor të deklaruar nga paditësi nuk kërkohet certifikata L02 (certifikatë fito sanitare) ndërsa në kodin tarifor që është klasifikuar nga dogana kërkohet certifikata L02.

Andaj në referencë të sistemit Asycuda certifikata L02 është siguruar dhe është bashkangjitur në sistem vetëm pasi që sektori i tarifës ka klasifikuar mallin në kodin tarifor 3808949000. Po ashtu vlen të sqarohet se pavarësisht faktit se taksat paguhen nga importuesi subjekti si agjension i specializuar për deklaram të mallit dhe si i autorizuar i paditësit është përgjegjës për klasifikim të drejtë të mallit bazuar në gjendjen faktike. Për informimin tuaj dogana pranon gabimet e mundshme deri në momentin kur ato lajmërohen nga vet paditësi apo subjekti ankimor, por jo edhe atëherë kur shkeljet zbulohen si rezultat i kontroleve nga dogana gjithnjë në referim të nenit 69 pika a), b) dhe c). Së fundi ka theksuar se në këtë rast paditësi nuk ka dëshmuar se ka ndërmarrë ndonjë veprim për të përmirësuar DUD-in gjatë fazës së importit, pra para se mallit të klasifikohet nga sektori i tarifës. Gjykatës i propozoi që të refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar, të merren për bazë të gjitha shkresat e lëndës të administruara dhe të lë në fuqi vendimin kontestues si të drejtë dhe të ligjshëm.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 13.06.2024, ka administruar provat si në vijim: Aktvendimin 01.3.2.2/7013 e datës 26.05.2021, Aktvendimin nr. 03.1.7-2021-488 e datës 20.04.2021, Procesverbal mbi kundërvajtje administrative doganore e datës 20.04.2021, DUD R7502, Faturë SOL0949, Pagesa e kundërvajtjes e datës 21.04.2021 dhe urdhërpagesa e doganës, TARIK, Ankesa në doganë e datës 22.04.2021, Kontrolli fito sanitar kufitar.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit me të cilin këtu paditësi ishte shpallur përgjegjës për kundërvajtje doganore sipas nenit 276 pika (h) dhe të njëjtit i është shqiptuar gjoba në vlerë prej 500 euro. Shkak i kësaj gjobe ka qenë se paditësi gjatë kontrolles nuk ka paraqitur saktë të dhëna me anë të deklaratës doganore R 7502/2021 me emërtimin gjel për pastrimin e menjëhershëm të duarve me kodin tarifor 2905120000, ndërsa nga sektori i tarifës është konstatuar se kemi të bëjmë me dezinfektues me kodin tarifor 3808949000 e që me veprimin e tillë doganës nuk i ka ofruar sqarimet e nevojshëm për zbatimin e procedurës doganore duke rënë ndesh me dispozitat e nenit 276 par. h) të KDAK-së. Më tej ka arsyetuar se është fakt se bazuar në kodin tarifor të deklaruar nga paditësi nuk kërkohet që të paguhen taksat doganore prej 10%, ashtu siç nuk kërkohet edhe me kodin tarifor të klasifikuar nga sektori i tarifës, mirëpo në kodin tarifor të deklaruar nga paditësi nuk kërkohet certifikata L02 (certifikatë fito sanitare) ndërsa në kodin tarifor që është klasifikuar nga dogana kërkohet certifikata L02. Andaj në referencë të sistemit Asycuda

certifikata L02 është siguruar dhe është bashkangjitur në sistem vetëm pasi që sektori i tarifës ka klasifikuar mallin në kodin tarifor 3808949000.

Gjykata nga DUD-i R-7502/19.04.2021, ka gjetur se i njëjti është deklaruar nga këtu paditësi me anë të faturës nr. CBHU8791300 të datës 23.03.2021, me vlerë sikurse në faturë 36,211.20 euro, me kod tarifor 2905120000, dhe me përshkrim sikurse në faturë dhe rubrikën nr. 31 të këtij DUD-i, tutje kjo deklaratë doganore është ndryshuar pasi nga Sektori i tarifës ka marr përgjigje se kodi i deklaruar është i gabuar dhe se duhet të jetë 3808949000.

Gjykata vlerëson se nuk qëndron pretendimi i paditësit se e paditura ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për arsye se, nga shkresat e lëndës dhe atë nga ankesa e palës rezulton se i njëjti pranon se është gabim teknik, mirëpo nuk thekson se ka pasur L02, ndërsa nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi e ka siguruar dhe bashkangjitur certifikatën fitosanitare L02 vetëm pasi e paditura-Sektori i Tarifës e ka klasifikuar mallin në kodin tarifor 3808 949000.

Me nenin 69, paragrafi 1, të KDA-së, shprehimisht përcaktohen rastet kur mund të ndryshohen të dhënat në Dokumentet Unike Doganore dhe atë: *“Me kërkesën e tij, deklaruesit mund t’i lejohet nga Dogana të ndërrojë një ose më shumë të dhëna në deklaratë, pasi ajo të jetë pranuar nga Dogana. Ndërrimi i të dhënave nuk do të ketë efekt që ta bëjë deklaratën të zbatueshme për mallrat tjera nga ato që janë deklaruar fillimisht në të”*. Megjithatë, në vijim të kësaj dispozite taksativisht thuhet se : *“asnjë ndërrim nuk lejohet kur kërkesa është ushtruar pasi Dogana: b) ka arritur në përfundim se të dhënat në fjalë janë të pasakta “*. Prandaj, në interpretim të drejtë të kësaj dispozite Gjykata vlerëson se certifikata është bashkangjitur me datën 20.04.2021, ndërsa DUD-i është deklaruar me datë 19.04.2021. Andaj konform dispozitave të lartcekura, Gjykata konstaton se në rastin konkret nuk kemi shkelje esenciale të dispozitave të KDA-së.

Gjykata pretendimin e paditësit se e paditura përveç se e ka cituar nenin 276 nuk e ka arsyetuar se çfarë procedurash doganore nuk kanë qenë të mundura të zbatohen me veprimin e paditësit, nuk qëndron ngase e paditura mjaftueshëm e ka sqaruar se për kodin e deklaruar nuk kërkohet L02, ndërsa për atë të riklasifikuar kërkohet L02 dhe se dokumenti i njëjtë është bashkangjitur vetëm pasi është deklaruar malli, përkatësisht është riklasifikuar nga dogana.

Në nenin 273 të KDAK-së është paraparë që *“1. Shkeljet në fushën doganore nënkuptojnë Kundërvajtjet administrative doganore dhe veprat penale. 2. Duke përjashtuar rastet e fuqisë*

madhore, çdo veprim ose mosveprim, që bie ndesh me dispozitat e parashikuara me këtë Kod, me aktet nënligjore për zbatimin e tij dhe me dispozitat tjera në fuqi në Kosovë, quhet Kundërvajtje Administrative Doganore". Nga interpretimi i drejtë i këtyre dispozitave ligjore, gjykata vlerëson se paditura drejt e ka zbatuar ligjin, kur paditësen e ka shpallur përgjegjës për kryerje të kundërvajtjes administrative doganore nga neni 276 pika h) të KDAK-së dhe i ka shqiptuar gjobë në shumë prej 500.00€, sepse e njëjta ka kryer shkelje doganore kur në procedurë të zhdoganimit të mallit përmes DUD-it R-7502/19.04.2021 ka deklaruar mallin me kod tarifor 2905120000, kurse është dashtë të deklarohet me kodin tarifor 3808 949000, si mall që duhet të posedoj L02, e i cili mall nuk mund të zhdoganohet pa deklarimin e L02, me këtë Doganës nuk i ka ofruar shënimet, sqarimet dhe dokumentet e nevojshme për zbatimin e procedurës doganore.

Prandaj në bazë të gjendjes faktike, ballafaqimit dhe ekzaminimit të gjitha provave në dosje të dokumentacionit shkresor, gjykata si përfundim konstaton se vendimi i Doganës së Kosovës nr. 01.3.2.2/22913 i datës 29.12.2021 është i drejt dhe i bazuar në dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-099.

Gjykata vendosi për shpenzimet e procedurës në pajtim me nenin 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, pasi që sipas këtij neni në konflikt administrativ secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Nga të cekurat më lart, Gjykata konform me dispozitave ligjore të nenit 43 par, 1, dhe nenit 46, par. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.466/22, datë 13.06.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.